LAJME TË MIRA NGA

SUNDIMI I LIGJI

RAPORTI TREMUJOR 9



THEKSOHET PROGRES I DUKSHËM DHE ANGAZHIM I PËRBASHKËT NË TAKIMIN E PESTË TË BORDIT UDHËHEQËS

PUNËTORIA PËR RIORGANIZIMIN E POLICISË PËRPARON MODERNIZIMIN E POLICISË

VIZITA STUDIMORE NË PORTUGALI PËR GJYQËSORIN DHE VIENË PËR DHUNËN ME BAZË GJINORE

TRAJNIM KUNDËR DISKRIMINIMIT NË PUNËN E POLICISË

EU SUPPORT FOR RULE OF LAW

NËNTOR 2025

KY RAPORT U FINANCUA NGA BASHKIMI EVROPIAN. PËRMBAJTJA E TIJ ËSHTË PËRGJEGJËSI E VETME E LUDWIG BOLTZMANN GESELLSCHAFT - INSTITUTI I TË DREJTAVE THEMELORE DHE TË NJERIUT (LBI-GMR) DHE NUK PASQYRON DOMOSDOSHMËRISHT PIKËPAMJET E BASHKIMIT EVROPIAN.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PARATHËNIE



Diter SHINDLAUER

Udhëheqës Ekipi, Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit

"Po e shfrytëzojmë këtë botim që të vazhdojmë të mbajmë lartë moralin dhe etikën e besimit në një arsye të shëndoshë për ndryshim, reforma dhe proces të vazhdueshëm përmirësimi. Për të bërë këtë, do të flasim mbi hapat e bëra përpara dhe do të festojmë për to në mënyrë që të mos humbasin në lajmet jo aq pozitive që janë gjithmonë më të zëshme."

I dashur lexues,

Të nderuar lexues, raporti ynë i tremujorit të nëntë po zgjerohet përtej kufijve të Maqedonisë së Veriut, pasi një pjesë e madhe i dedikohet tri vizitave të fundit studimore– dy në Portugali dhe një në Austri. Vizitat studimore ofrojnë mundësi për tu larguar nga përditshmëria dhe për t'u angazhuar me përvoja që japin emocion dhe frymëzim. Besojmë se vizitat e përshkruara në këtë botim janë shembull i shkëlqyer se si duken përvojat e këtilla. Ato janë përplot me aktivitete, përfshirë këtu takime, biseda intenzive, prezantime dhe diskutime. Raportet thonë se ato rezultuan si të suksesshme në kuptimin që pjesëmarrësit morën me vete plot ide lidhur me atë se si të përmirësojnë fushat me të cilat merren në vend. Ky është edhe qëllimi: përvoja e asaj që perceptohet si praktikë e mirë në një shtet anëtar të BE-së është vetëm fillimi. Puna e vërtetë fillon me përcaktimin nëse dhe si mësimet mund të transformohen dhe transferohen në realitetin dhe të ardhmen e Maqedonisë së Veriut. Jam i sigurt se vizitat studimore janë motori i duhur dhe frytdhënës për një ndryshim të tillë.

Një tjetër storje në këtë raport për të cilën jam personalisht shumë i lumtur dhe madje krenar është “Mega-trajnimi” i mbi 400 kadetëve të policisë në Idrizovë.

PARATHËNIE

Për pesë ditë, një ekip prej gjashtë trajnerësh punoi me Qendrën e Trajnimit të Policisë dhe kadetët e saj në tre grupe paralele. Trajtuam çështje të paanshmërisë, barazisë në shërbim, paragjykimeve dhe stereotipeve - çështje që nuk janë të lehta për t'u trajtuar, por janë shumë të rëndësishme për të gjithë profesionistët e zbatimit të ligjit. Atmosfera ishte e jashtëzakonshme – përzierje e këndshme mes disiplinës dhe sinqeritetit, mikpritjes dhe pritshmërive. Në këtë raport, do të gjeni një përmbledhje autentike të katër kadetëve të trajnuar se si e perceptuan trajnimin për t'ju dhënë një përshtypje të çështjeve të trajtuara. Shpreh mirënjohjen time për personat përgjegjës brenda Qendrës së Trajnimit të MPB-së, me falënderime të veçanta për znj. Daniela Spasovskën, Shefe e Njësisë për Zhvillimin e Kurrikulës, dhe kadetët që dhanë pikëpamjet e tyre personale për këtë raport, Angela Taneska, Ivana Milloshevska, Angell Mlladenovski dhe Damjan Dimovski. Dhe të gjithë kadetëve pjesëmarrës: ju faleminderit për pjesëmarrjen aktive dhe me respekt si dhe për përkushtimin që treguat!

Një tjetër ngjarje e madhe që lidhet me Ministrinë e Brendshme dhe policinë ishte seminari i nivelit të lartë mbi riorganizimin e policisë i mbajtur më 21 tetor në Shkup. Ai iu kushtua ripërcaktimit të strukturave të brendshme për të përmirësuar komunikimin dhe efikasitetin. Ky është një sinjal inkurajues për modernizim.

Në po këtë periudhë, ekspertët tanë për provën vizituan zyrat e provës në Shkup, Tetovë dhe Kumanovë për të punuar në praktikë me oficerët e provës atje dhe për të mbledhur pikëpamjet dhe kontributet e tyre mbi zgjedhjet dhe sfidat strategjike. Si gjithmonë, ekspertët mbetën të mahnitur nga niveli i lartë i motivimit dhe kuriozitetit profesional që hasën gjatë vizitave të tyre, dhe do të kthehen për të vizituar shtatë zyra të tjera rajonale të provës.

Shijoni lajmet e mira!

Diter Shindlauer
Udhëheqës Ekipi



JU PREZANTOJMË:

TRAJNIM MBI ANTIDISKRIMINIMIN NË PUNËN POLICORE

Mbi 400 kandidatë të ardhshëm për policë morën pjesë në një kombinim ushtrimesh teorike dhe praktike që synonin diskutimin, analizimin dhe mësimin se si të njohin dhe parandalojnë diskriminimin në punën e tyre të përditshme.

VIZITA STUDIMORE

Vizitat studimore gjyqësore në Lisbonë u përqëndruan në avancimin e standardeve evropiane në llogaridhënien dhe vlerësimin gjyqësor, si dhe një vizitë studimore në Vjenë që synonte forcimin e politikave dhe kornizave mbrojtëse për dhunën me bazë gjinore.

PUNËTORIA MBI RIORGANIZIMIN E POLICISË FORCON MODERNIZIMIN E POLICISË

Kjo ngjarje ofroi një mundësi të shkëlqyer për të shkëmbyer përvoja, për të mësuar nga praktikat e mira evropiane dhe për të diskutuar sfidat dhe mundësitë në transformimin e vazhdueshëm të policisë maqedonase.

Të flasim për...

- Progres i dukshëm dhe përkushtim i përbashkët i theksuar në mbledhjen e pestë të bordit udhëheqës
- Kandidatë të rinj për policë përqafojnë mësimin thelbësor të trajtimit të barabartë: "Diskriminimi nuk është gjithmonë i dukshëm; shpesh ai është i rrënjosur në nëndijen tonë."
- Simulimi (tabletop) për luftën ndaj terrorizmit forcon gatishmërinë e reagimit ndaj krizave në Policinë e Maqedonisë së Veriut
- Mision mes kolegësh (Peer-to-Peer) në Zyrat Rajonale të Provës
- Punëtoria mbi riorganizimin e policisë bën bashkë palët kryesore për të çuar përpara modernizimin e Policisë së Maqedonisë së Veriut
- Vizita studimore:
  - Vizitë studimore gjyqësore në Lisbonë: Hapja e rrugës drejt standardeve evropiane në llogaridhënien dhe vlerësimin gjyqësor
  - Përmirësimi i politikave dhe kuadrit të mbrojtjes kundër dhunës me bazë gjinore përmes njohurive nga vizitat studimore
  - Forcimi i efikasitetit të shërbimit të prokurorisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut – rritja e kapaciteteve operacionale të Prokurorisë Publike dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë

Progresi i dukshëm dhe angazhim i përbashkët u theksuan në Takimin e Pestë të Bordit Udhëheqës

Projekti ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'' mbajti Takimin e Pestë të Bordit Udhëheqës më 18 shtator 2025 në ambientet e Klubit të Deputetëve. Gjatë takimit fokusi ishte në prezantimin e rezultateve të projektit nga shkurti deri në gusht 2025 dhe në përcaktimin e hapave të ardhshëm.

Znj. Marzia Palota, përfaqësuese e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Maqedoninë e Veriut (DEU), theksoi mbështetjen e vazhdueshme të BE-së për reformat në sektorin e sundimit të ligjit, duke shpërfaqur progresin e arritur në të katër objektivat e projektit dhe duke theksuar rëndësinë e dialogut të vazhdueshëm me ekipin e projektit dhe përfituesit. Znj. Agnes Taibl, Drejtoreshë e Projektit nga Instituti Ludvig Boltzman për të Drejtat Themelore dhe të Njeriut, theksoi se dy të tretat e rezultateve të planifikuara janë arritur tashmë ose janë afër përfundimit, duke konfirmuar se projekti është në rrugën e duhur. Nga kohëzgjatja 42 mujore e projektit kanë kaluar 29 muaj. Ajo falënderoi ekipin e projektit, institucionet përfituese, Delegacionin e BE-së dhe partnerët e konsorciumit për angazhimin dhe mbështetjen e tyre. Udhëheqësi i Ekipit, z. Diter Shindlauer, theksoi se bashkëpunimi me përfituesit ka arritur në një nivel ku ekspertët e projektit janë plotësisht të integruar si burime në punët e përditshme, që vjen si rezultat i besimit dhe respektit të fortë të ndërsjellë.







Nga gushti 2024 deri në shkurt 2025, projekti ka arritur përparim të konsiderueshëm në të katër komponentët, dhe pikat kryesore më poshtë përshkruajnë disa nga sukseset e tij.

Komponenti 1, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor, Zyrën e Prokurorit Publik dhe Akademinë për Prokurorë Publikë dhe Gjyqtarë, forcohet gjyqësori përmes përmirësimeve në menaxhimin e burimeve njerëzore, optimizimit të hartës gjyqësore, mbështetjes për sisteme të reja IT, trajnimeve të synuara dhe vlerësimeve fiskale për të siguruar zbatimin efektiv të Strategjisë Gjyqësore 2024–2028.



Komponenti 2, me Ministrinë e Brendshme si përfituesin kryesor, forcohet lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit përmes trajnimeve të specializuara, udhëzimeve dhe dokumenteve strategjike, ndërsa fillon edhe fushata ndërgjegjësuese "0% Korrupsion - Ta bëjmë realitet!" për të inkurajuar qytetarët të raportojnë korrupsionin pa hezitim.



Komponenti 3, bashkë me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), jepen rezultate kyçe përfshirë këtu Sistemin e Menaxhimit me Burime Njerëzore, Strategjinë e Komunikimit në Kriza, kursin IACA dhe propozimin e parë të Strategjisë së TIK-ut.



Komponenti 4, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, Zyrën e Avokatit të Popullit, Komisionin për Parandalimin e Diskriminimit dhe Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve, avancohet mbrojtja e të drejtave të njeriut përmes Forumit të të Drejtave të Njeriut, Bisedave për Barazinë, trajnimin e trajnerëve mbi antidiskriminimin, lançimin e Qendrës së Burimeve Elektronike mbi barazinë dhe miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2025–2029.



Përfaqësuesit e institucioneve partnere shprehën vlerësimin e tyre për mbështetjen e vazhdueshme të projektit dhe kontributin e tij të vlefshëm në forcimin e sundimit të ligjit.
Në takimin ku morën pjesë 50 përfaqësues nga Delegacioni i BE-së, partnerët e konsorciumit, institucionet përfituese dhe ekspertët, u theksua angazhimi i përbashkët për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe transparente në Maqedoninë e Veriut.





Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











Kandidatët e rinj për policë përshëndesin mësimin thelbësor të trajtimit të barabartë: “Diskriminimi nuk është gjithmonë i dukshëm; shpesh, ai është i rrënjosur në ndërdijen tonë.”

Në kuadër të projektit "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit", u mbajt trajnim interaktiv mbi antidiskriminimin në punën policore me gjeneratën e re të kandidatëve për policë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
Ky trajnim është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të rritur aftësitë e oficerëve të ardhshëm të policisë në fushat e të drejtave të njeriut, trajtimit të barabartë dhe etikës profesionale.

Mbi 400 kandidatë për policë morën pjesë në një kombinim ushtrimesh teorike dhe praktike që synonin diskutimin, analizimin dhe mësimin se si të njohin dhe parandalojnë diskriminimin në punën e tyre të përditshme. Për shumë prej tyre, ky trajnim ofroi mundësi unike për të reflektuar mbi mënyrat delikate se si paragjykimet dhe stereotipet mund të ndikojnë në marrëdhëniet e tyre profesionale me qytetarët.

> "Trajnimi ishte ndryshe nga çdo gjë që kemi pasur ndonjëherë më parë; përshtypja ime është shumë pozitive", thotë Angela Taneska, një nga pjesëmarrëset.
>
> "Ajo që më pëlqeu më shumë ishte se nuk ishte vetëm teorik, por përfshinte edhe shumë shembuj dhe diskutime praktike. U habita nga mënyra se si format delikate të diskriminimit mund të shfaqen në punën e përditshme, pa i vënë re menjëherë."



Ajo shton se mësimi më i rëndësishëm që mori ishte se diskriminimi nuk është gjithmonë i dukshëm ose i qëllimshëm.

“Ndonjëherë është rezultat i paragjykimeve që i mbajmë me vete në mënyrë të pavetëdijshme. Kuptova se edhe një veprim ose fjalë e vogël mund të ketë një ndikim të madh në besimin e qytetarëve”, shpjegon Angela.

Angel Mlladenovski mendon ngjashëm, duke thënë se është pikërisht një trajnim i tillë që i ndihmon oficerët e rinj të policisë të bëhen më të vetëdijshëm për përgjegjësinë që sjell profesioni i tyre.

> “Diskriminimi mund të jetë edhe sistemik, domethënë, ’i integruar’ në institucione, ligje ose tradita shoqërore që krijojnë mundësi të pabarabarta për grupe të caktuara. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të mësohet të njihen këto mekanizma dhe të veprohet profesionalisht dhe në mënyrë të barabartë ndaj të gjithëve”, thotë ai.



Për Ivana Milloshevskën, gjëja më e vlefshme ishte se trajnimi u zhvillua në një mënyrë interaktive dhe pozitive.



> “Trajnerët ishin shumë të përgatitur dhe arritën të na përcjellin njohuritë përmes lojës dhe të qeshurave. Mësova se diskriminimi shpesh shfaqet përmes veprimeve ose paragjykimeve të vogla, të pavetëdijshme, dhe jo gjithmonë përmes fyerjeve të hapura ose urrejtjes”, ndan ajo.

Për të gjithë pjesëmarrësit, momenti më i paharrueshëm ishte kur të gjithë duhej të krijonin një histori/biografi për njerëz të ndryshëm bazuar në një foto të vetme. Kur më vonë e zbuluan historinë e vërtetë, secili u përball me supozimet dhe paragjykimet e veta.

> “Nga ai ushtrim, mësuam se nuk duhet t’i gjykojmë kurrë njerëzit nga pamja e tyre, sepse secili ka historinë e vet”, thotë Damjan Dimovski.



Përveç njohurive të reja, kandidatët ranë dakord se ky trajnim do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhmen e tyre si oficerë policie.

“Do të jem shumë më e kujdesshme në marrëdhënien time me të gjithë qytetarët, pavarësisht etnisë, gjinisë apo fesë që kanë ”, thotë Angela Taneska.

“Unë besoj se me respekt dhe mirëkuptim, policia mund të bëhet më e afërt dhe më efikase.”

Pjesëmarrësit theksuan se trajnime të tilla jo vetëm që ndërtojnë ndërgjegjësim dhe empati, por edhe forcojnë marrëdhënien midis policisë dhe qytetarëve.

“Kur njerëzit ndiejnë se trajtohen në mënyrë të drejtë dhe me respekt, ata bashkëpunojnë më lehtë dhe kanë më shumë besim në institucione”, theksoi Mlladenovski.



Diskriminimi – njohja, mirëkuptimi dhe përgjegjësia

Përgjigjet nga kandidatët e rinj tregojnë se ata e kuptojnë diskriminimin si një çështje thelbësore në krijimin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Diskriminimi nuk është gjithmonë i dukshëm ose i qëllimshëm; ai mund të lindë nga paragjykime të pavetëdijshme ose tradita kulturore që përcillen brez pas brezi. Siç demonstruan kadetët e rinj, hapi i parë drejt ndryshimit bëhet me mirëkuptim, empati dhe trajtim të të gjithëve në mënyrë të barabartë.

Trajnimi kundër diskriminimit është pjesë e aktiviteteve më të gjera të projektit "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit", që synon forcimin e kapaciteteve të oficerëve të policisë dhe ndërtimin e besimit me komunitetin.









Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











Simulimi mbi luftën kundër e terrorizmit forcon gatishmërinë e Policisë Maqedonase për reagim ndaj krizave

Në Shkup u mbajt një ushtrim simulues për luftën kundër terrorizmit, duke bërë bashkë 22 përfaqësues nga sektorë dhe njësi të ndryshme të Ministrisë së Brendshme. Ushtrimi synonte të testonte dhe verifikonte përshtatshmërinë dhe koherencën e planeve ekzistuese operative, kornizave të reagimit dhe protokolleve të sigurisë në një mjedis të simuluar krize.

Përmes diskutimeve të bazuara në skenare reale, pjesëmarrësit ushtruan rolet dhe përgjegjësitë e tyre, forcuan vendimmarrjen nën presion dhe identifikuan boshllëqet e mundshme në koordinim, komunikim dhe menaxhim krizash.

Një seancë informimi e mbajtur të nesërmen mblodhi 10 drejtues sektorësh dhe njësish për të diskutuar gjetjet, për të shkëmbyer zgjidhje dhe për të shqyrtuar rrjetin operativ të reagimit ndaj krizave - EuNAT, i cili ofron qasje të strukturuar për menaxhimin e emergjencave komplekse.

Ushtrimi riafirmoi angazhimin e Ministrisë për të përmirësuar bashkëpunimin ndërdepartamental, për të forcuar gatishmërinë dhe për të rritur qëndrueshmërinë e përgjithshme të Policisë Maqedonase në reagimin ndaj terrorizmit dhe incidenteve të tjera të sigurisë me intensitet të lartë.



Misioni i Bashkëpunimit mes Kolegëve në Zyrat Rajonale të Provës

Katër ekspertë ndërkombëtarë (EN) nga Shërbimi i Provës dhe gjyqësori në Republikën e Kroacisë zbatuan misione ndërgjegjësimi dhe ndërtimi kapacitetesh koleg-me-koleg në zyrat e provës në Shkup, Tetovë dhe Kumanovë, duke punuar me 16 oficerë të provës.
Një nga EN-të, Vesna Zeliç Ferençiç, Drejtuese e Shërbimit për Zhvillimin e Sistemit të Provës në Ministrinë e Drejtësisë, Administratës Publike dhe Transformimit Dixhital të Republikës së Kroacisë, i sheh "oficerët e provës si shumë të motivuar dhe të etur për të zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e tyre profesionale. Duke pasur parasysh vendosjen e tyre brenda gjykatës, ata kanë tendencë ta perceptojnë veten si të varur nga gjyqtarët dhe jo si profesionistë të barabartë, duke treguar nevojë për të forcuar besimin e tyre profesional dhe vetë-perceptimin, si individualisht ashtu edhe në nivel shërbimi.''

> "Misionet kolegë-me-kolegë synojnë pikërisht ndërtimin e kapaciteteve për secilin oficer të provës dhe zhvillimin organizativ. ISTE Matea Srshen, Drejtoreshë e Zyrës së Provës në Zagreb, e përshkruan "misionin e saj në zyrën e provës në Shkup si një javë plot me mësim, ndarje dhe punë të vërtetë në grup".

Gjatë misioneve, zyrat e provës në Maqedoni bënë intervista me shkelësit e ligjit dhe zbatuan vizita në terren për të gjetur shkelësit që nuk u paraqitën për intervista. Më pas, zyrtarët e provës morën reagime të gjera duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta dhe duke ofruar rekomandime për përmirësimin e praktikave të intervistimit nga ana e Inspektorëve të Shërbimit të Provës.

> Matea Srshen përshkruan si pikat kryesore "vëzhgimin e intervistave të vërteta dhe zhvillimin e diskutimeve të hapura dhe konstruktive që forcuan besimin dhe lidhjen profesionale. Oficerët e vlerësuan atmosferën mbështetëse dhe mundësinë për të shkëmbyer përvoja në një mënyrë të relaksuar dhe respektuese".

> Kolegia e saj, Vesna Zeliç Ferençiç, shton se "Qasja praktike e vëzhgimit se si oficerët maqedonas të provës zbatojnë teknikat e intervistimit dhe integrojnë njohuritë e fituara nga trajnimi dhe edukimi ka rezultuar veçanërisht e vlefshme".

Për më tepër, oficerët maqedonas të provës ndanë reagimet e tyre mbi versionin e përditësuar të mjetit të vlerësimit të riskut, i cili ndihmon në vlerësimin dhe prodhimin e një qasjeje të përshtatshme për të zvogëluar mundësinë e përsëritjes së veprës penale. Zyrtarët maqedonas të provës patën gjithashtu mundësinë të diskutonin statusin e zbatimit të Strategjisë aktuale për Zhvillimin e Shërbimit të Provës në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2025) dhe dhanë sugjerime për përmirësime si në fushat ekzistuese ashtu edhe në ato të reja potenciale për strategjinë e ardhshme.

Vesna Zeliç Ferençiç thekson një fushë për të forcuar më tej shërbimin e provës:

> “Edhe pse zyrat rajonale të provës veprojnë në mënyrë uniforme në përputhje me protokollet e përcaktuara, ekzistojnë dallime të dukshme: Ka zyra që janë më aktive dhe demonstrojnë pavarësi më të madhe, p.sh., duke organizuar takime me gjyqtarë ose duke angazhuar palët e interesuara. Këto zyra duket se janë më të kënaqura me rolin e tyre brenda sistemit të drejtësisë penale. Kjo nënvizon më tej rëndësinë e decentralizimit të aktiviteteve të caktuara dhe emërimit të udhëheqësve të zyrave lokale, të mbështetur dhe mbikëqyrur nga zyra qendrore.”



> Matea Srshen përfundon se “misioni ishte gjithashtu një përvojë mësimi për ne si ekspertë, duke ofruar njohuri të vlefshme mbi realitetet e praktikës së provës dhe angazhimin e fortë të oficerëve në punën e tyre. Ai tregoi se si bashkëpunimi dhe mësimi nga kolegët mund të frymëzojnë motivim dhe krenari në ndërtimin e një shërbimi më të fortë të provës.”

Projekti do të vazhdojë mbështetjen e tij motivuese dhe profesionale për zyrat rajonale të provës me misione nga kolegët në zyrat në Manastir, Kavadar, Ohër, Prilep, Shtip, Strumicë dhe Veles.



Punëtoria mbi riorganizimin e policisë mbledh palët kryesore me interes për të çuar përpara modernizimin e Policisë maqedonase

Në Shkup u mbajt punëtoria kushtuar riorganizimit dhe zhvillimit të policisë maqedonase në nivel kombëtar, qendror dhe rajonal-lokal, duke bashkuar përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Policia dhe ekspertë ndërkombëtarë. Kjo ngjarje ofroi mundësi të shkëlqyer për të shkëmbyer përvoja, për të mësuar nga praktikat e mira evropiane dhe për të diskutuar sfidat dhe mundësitë në transformimin e vazhdueshëm të policisë maqedonase.

Eksperti i projektit, Matjazh Jerkiç, Drejtor i Drejtorisë së Policisë Kriminale të Policisë Sllovene, mbajti një prezantim të detajuar mbi strukturën dhe modelin e menaxhimit të Policisë Sllovene, i ndjekur nga një diskutim i hapur dhe dinamik.





Në punëtori morën pjesë Ministri i Brendshëm i Maqedonisë së Veriut, Pançe Toshkovski, dhe Drejtori i Policisë së Maqedonisë së Veriut, Aleksandar Janev.

Ministri shprehu interes se si Sllovenia e përmirësoi efikasitetin përmes përmirësimit organizativ, ndërsa Drejtori u përqendrua në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve analitike brenda Policisë Kriminale. Angazhimi dhe pyetjet e tyre të thelluara kontribuan ndjeshëm në cilësinë e diskutimit dhe demonstruan një angazhim të vërtetë për reformën dhe modernizimin institucional.

Seminari rezultoi në angazhim të përbashkët për të forcuar më tej funksionet analitike, organizative dhe hetimore të policisë, për të përmirësuar bashkëpunimin midis niveleve qendrore, rajonale dhe lokale, dhe për të investuar në zhvillimin profesional dhe lidershipin etik.

Me këtë ngjarje u konfirmua edhe një herë se ndarja e përvojave praktike dhe metodologjive të reformës nga Vendet Anëtare të BE-së, si Sllovenia, mund të luajë një rol jetik në ndërtimin e një shërbimi policor modern, efikas dhe të besueshëm nga qytetarët.



Photos: © Ministry of interior



VIZITA STUDIMORE



Vizitë studimore gjyqësore në Lisbonë: Hapja e rrugës për standardet evropiane në llogaridhënien dhe vlerësimin gjyqësor

Nga 14 deri në 16 tetor, duke hapëruar drejt forcimit të sundimit të ligjit në Maqedoninë e Veriut, Projekti ynë mbështeti Vizitën Studimore të nivelit të lartë për Këshillin Gjyqësor të Maqedonisë së Veriut (KGJ) në Këshillin e Lartë Gjyqësor të Portugalisë (KLP) dhe Gjykatën Supreme të Drejtësisë të Portugalisë në Lisbonë. Delegacioni, i cili përfshinte Kryetarin e KL dhe 11 anëtarë të KL, u përqendrua në përafrimin e proceseve të vlerësimit gjyqësor dhe disiplinës me standardet e vendosura evropiane.

Vizita u planifikua ashtu që të mund të përfitohet nga reformat e iniciuara nga rekomandimet e Misionit të Kontrollit nga Kolegët të BE-së për Këshillin Gjyqësor të vitit 2023 dhe Axhendën e Reformës së BE-së për Maqedoninë e Veriut, të cilat tani po rezultojnë në propozim-amendamente në Ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe një rishikim të Metodologjisë së KL-së për Vlerësimin e Performancës Gjyqësore. KLP-ja e Portugalisë u zgjodh si partner i përshtatshëm për shkak të kuadrit të saj të krahasueshëm institucional dhe përvojës së saj të mirë-vendosur në emërimet, vlerësimet dhe procedurat disiplinore gjyqësore.



Për tre ditë me radhë, delegacionet nga Maqedonia e Veriut dhe Portugalisë morën pjesë në mësim të drejtpërdrejtë, duke marrë njohuri praktike mbi metodologjitë e dallueshme kombëtare për emërimet, ngritjet në detyrë dhe vlerësimet e performancës në gjyqësor. Gjyqtarë të lartë dhe zyrtarë nga institucionet portugeze mbajtën prezantime, duke ndarë praktikat më të mira mbi menaxhimin e karrierës, etikën dhe cilësinë gjyqësore. Vizita përfundoi me një shqyrtim të rolit të Gjykatës Supreme në procedurën e apelit kundër vendimeve disiplinore të CSM-së, duke ofruar një kuptim të procesit të llogaridhënies gjyqësore në Portugali.



Njohuritë e fituara nga vlerësimi i sistemit portugez tani do të integrohen në reformat e vazhdueshme të Gjykatës Supreme. Kjo përfshin përdorimin e modelit të Portugalisë për të ndryshuar Metodologjinë e Gjykatës Supreme për Vlerësimin e Performancës Gjyqësore, zbatimin e ndryshimeve të ardhshme në Ligjin për Këshillin Gjyqësor në lidhje me procedurat disiplinore dhe udhëzimin e Gjykatës Supreme në forcimin e pavarësisë së vet. Rezultati i këtij bashkëpunimi është një udhëzues konkret, i bazuar në prova, i orientuar drejt modernizimit të funksioneve kryesore të Gjykatës Supreme dhe sigurimit të llogaridhënies më të madhe gjyqësore dhe besimit publik në Maqedoninë e Veriut.



Përmirësimi i politikave dhe kuadrit mbrojtës për dhunën me bazë gjinore përmes njohurive nga vizitat studimore

Përfaqësuesit e Ministrisë së Politikave Sociale, Demografisë dhe Rinisë (MPSDR), Qendrës për Punë Sociale (QPS) dhe Qendrës së Referimit për Viktimat e Dhunës Seksuale morën pjesë në një vizitë studimore mbi "Mënyrat e forcimit dhe përmirësimit të mbrojtjes së viktimave në fushën e dhunës me bazë gjinore" në Vjenë, Austri.

Vizita studimore promovoi një qasje të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të përqendruar te viktima në zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe masave që kontribuojnë në një kornizë gjithëpërfshirëse që siguron mbrojtjen e viktimave dhe qasjen në drejtësi, mbështetjen e viktimave, mbledhjen e të dhënave të përmirësuara, parandalimin, koordinimin dhe bashkëpunimin. Mësimet e vizitës studimore do të jenë veçanërisht të dobishme për MPSDR-në për zhvillimin dhe zbatimin e një Strategjie të re Kombëtare për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna me Bazë Gjinore ndaj Grave dhe Dhuna në Familje 2026–2033, dhe për punën e Organit të Rivendosur Kombëtar të Koordinimit për Zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.



Përmbledhjet kryesore praktike nga vizita studimore:

Shpërndarja e njohurive: Ndani njohuritë e fituara dhe praktikat e mira në parandalimin e DHBGJ-së dhe DHF-së me të gjithë profesionistët dhe palët e interesuara përkatëse që punojnë në këtë fushë në Maqedoninë e Veriut.

Integrimi i politikave: Integroni masat e provuara të parandalimit dhe mbështetjes – siç janë programet e strehimit social për të mbijetuarit e DHBGJ-së të praktikuara në Vjenë - në Strategjinë Kombëtare Maqedonase për DHBGJ-në.

Reforma Institucionale: Të shqyrtohet mundësia e krijimit të një organi qeveritar të dedikuar (p.sh., Ministria për Gratë ose Çështjet e Grave) për të siguruar punë të koordinuar dhe strategjike mbi barazinë gjinore dhe parandalimin e DHBGJ-së.

Testimi i modelit përmes fondeve të BE-së: Të shfrytëzohen njohuritë mbi shërbimet e specializuara për fëmijët dhe të rinjtë për të hartuar dhe pilotuar modele të krahasueshme në Maqedoninë e Veriut, të mbështetura përmes IPA-s dhe programeve të tjera të BE-së.

Përmbledhjet kryesore praktike nga vizita studimore:

Angazhimi i burrave si aleatë: Rritja e përfshirjes së burrave në iniciativat e parandalimit të DHBGJ-së, duke përfshirë fushatat e ndërgjegjësimit që synojnë burrat dhe djemtë. Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të bazuara në shkolla dhe komunitet të fokusuara në punën me djemtë dhe të rinjtë për të parandaluar dhunën në të ardhmen.

Programet e parandalimit të dhunës për të rinjtë: Prezantimi i shërbimeve dhe procedurave të përmirësuara, profesionale dhe të informuara për traumat për fëmijët viktima të dhunës seksuale. Zhvillimi i koncepteve të projektit për krijimin e qendrave për ndërhyrje të hershme dhe parandalim për fëmijët viktima të dhunës.

Përshtatja e modeleve të shërbimit: Përdorimi i njohurive nga shërbimet ndërkombëtare për të përshtatur dhe futur modele mbështetëse të qëndrueshme, të përqendruara te të mbijetuarit në Maqedoninë e Veriut.

Përmirësimi i sistemit të linjave të ndihmës: Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të linjave të ndihmës për gratë dhe vajzat që janë të mbijetuara të dhunës, duke siguruar qasje dhe cilësi.

Forcimi i efikasitetit të shërbimit të prokurorisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut – rritja e kapaciteteve operative të Prokurorisë Publike dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë

Nga data 14 deri më 16 tetor, në kuadër të projektit tonë, përfaqësues të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Këshillit të Prokurorëve Publikë dhe Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë morën pjesë në një vizitë studimore në Lisbonë, Portugali.
Qëllimi i vizitës ishte t'u mundësonte pjesëmarrësve të njiheshin me kornizën ligjore, operacionet e përditshme dhe funksionimin e Këshillit të Prokurorëve Publikë, Prokurorisë Publike dhe Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë në një shtet tjetër anëtar të BE-së.

Gjatë vizitës në Prokurorinë Publike Portugeze dhe Këshillin e Lartë të Prokurorëve Publikë, delegacioni u njoh me kornizën ligjore dhe strukturën organizative të sistemit të prokurorisë në Portugali, me një fokus të veçantë në financimin dhe pavarësinë e sistemit prokurorial, transparencën e procedurave, si dhe mekanizmat e vlerësimit dhe mbikëqyrjes për prokurorët publikë. Ata u njohën gjithashtu me sistemin specifik për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e performancës përmes prezantimeve të mbajtura nga një prokuror përgjegjës për këto procese, të cilat janë thelbësore për zhvillimin e karrierës.



Pjesëmarrësit vizituan gjithashtu Zyrën e Prokurorit Publik të specializuar për Hetime në Lisbonë, ku Drejtoresha Maria de Lourdes Parada prezantoi sistemin elektronik të menaxhimit të lëndëve. Duke pasur parasysh se zhvillimi i një sistemi të ri IT për Zyrën e Prokurorit Publik në Maqedoninë e Veriut po vazhdon aktualisht, mjetet dhe funksionalitetet praktike të demonstruara ishin të një rëndësie të veçantë.



Gjatë vizitës studimore, u diskutuan disa aspekte institucionale dhe të së drejtës penale, duke përfshirë zbatimin e Kodit të Procedurës Penale dhe bashkëpunimin me autoritetet e tjera shtetërore. Kjo zyrë e specializuar prokurorie merret me lëndët më serioze dhe komplekse në Portugali, duke përfshirë hetimin e aksidentit të fundit që përfshiu teleferikun portugez "Glória".

Në Akademinë për Studime Ligjore në Lisbonë, pjesëmarrësit diskutuan dhe shkëmbyen përvoja në lidhje me kompetencat, strukturën organizative, financimin dhe programet për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të prokurorëve publikë.

Vizita studimore ofroi një mundësi të vlefshme për shkëmbim të drejtpërdrejtë të pikëpamjeve dhe njohurive praktike mbi organizimin e sistemit të prokurorisë dhe rolin e prokurorëve publikë, me një fokus të veçantë në sfidat që mund të ndikojnë në pavarësinë e Zyrës së Prokurorit Publik dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë.

Përmes këtyre takimeve, prezantimeve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të transferojnë dhe zbatojnë standardet, përvojat dhe praktikat më të mira në punën e tyre të përditshme, si dhe të kontribuojnë në zhvillimin e zgjidhjeve të reja ligjore në përputhje me standardet dhe praktikat më të larta ndërkombëtare



NËNTOR 2025 - SHKURT 2026

KALENDARI
NGJARJET E ARDHSHME

22 JANAR

Promovimi i Raportit mbi Zbatimin e Strategjisë së Burimeve Njerëzore në Gjyqësor dhe Udhëzesit të ri për Organizimin e Rrjetit Gjyqësor

Komponenti 1

12 NËNTOR

Punëtori mbi trafikimin ilegal të drogës - Sesioni II

Komponenti 2

13 NËNTOR

Forumi i 2-të i Impulseve: Kalimi nga parimet në praktikë - Përpilimi i ligjeve dhe masave përmes Qasjes së Bazuar në të Drejtat e Njeriut (HRBA)

Komponenti 4

11 DHJETOR **12 DHJETOR**

Trajnim mbi Analizën dhe Përpunimin e të Dhënave

Komponenti 3

20 NËNTOR

Konferenca "Pesë vjet parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi: arritjet dhe drejtimet e ardhshme"

Komponenti 4

EU SUPPORT FOR RULE OF LAW

IMPRINT

Botuesi: Ludwig Boltzmann Gesellschaft - Instituti i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut (LBI-GMR), Vjenë, në kuadër të Projektit "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit", Shkup
Redaktore: Kristina Vesiq
Korrektore: Ane Petrushevska
Periudha e raportimit: 8 gusht - 7 nëntor 2025
Data: 7 nëntor 2025

Financuar nga Bashkimi Evropian

BE-ja me TY